Neki Lulaj

BUKURI E BEKUAR

Copyright@Autori-2012

Neki Lulaj i jep prioritet substancës poetike, afshit të dashurisë dhe sentimentit që përfaqësojn zërin e zemrës dhe shpirtin e fjalës. Ai e ndjen veten të degdisur në mesnatë, duke parë se si biejnë yje dhe pëshpëritje nga qielli, fjalë të ëmbla dhe loti i heshtjes që të shoqëron. Shpirti i tij noton nëpër yje, duke tentuar ta prekë diellin e bënën dhe qellin. Dhe, kur dielli lind, shpirti i tij shndërrohet në det dashurie me reze shkëlqimtare dhe afshin e zjarrtë të përmallimit ndaj atdheut dhe bojve të shqipes që derdhën gjak për ta bërë Shqipërinë Shqipëri. Neki Lulaj është poeti i linisë, skulptor fjalësh dhe mjeshtër i artit poetik, i ngarkuar me meditime filozofike, ëndërrime, fluturime, përjetime të ëmbla e të dhimbshme, dhe, siç thekson Hasan Qyqalla, vargu i tij ka një përmbajtje të lartë artistike dhe një ndjeshmëri të thellë ku reflektohet realiteti i shqiptarizmit në Kosovë dhe Diasporë. Lëbër i mirë është si që na e kultivon shpirtin duke na pajisur me mendime e ndjenja të bukura. Frymëzimi buron nga syri magjik, gjaku i dashurisë dhe zëri i zemrës. Ne këtë vëllim defilojnë emocioni, dhembja dhe ballafaqimi me realitetin. Poeti shëmbëllen me ushtarin, me fmuullistarin apo me flamurtarin e batalionit. Lirika e Neki Lulajt është një forcë e gjallë e vitalitetit shqiptar me tingujt e gjallë të shqiptarizmit në diasporë: "Nëpër furtunën e detit/ Të lundrojmë së bashku/ Të dalim buzë Kepit/ Të Shpresës së Mirë/ Për ta ngritur Kalanë." Ai dëshmon se e ka përvetësuar historinë dhe e ka ndjerë gjuhën shqipe si një xeherore të florinjtë për të krijuar vlera të reja. Poeti është mbret që e kupton letërsinë si një ansambël meditimesh sociale, patriotike dhe filozofike, që ta përkujton Kantin e dikurshëm, i cili e kundronte kulturën si një gjeometri ku zotëronte teoria e tij si një metaforë e kohës, hapsirës dhe mjeteve tjera për rrumbullakësimin e jetës, një kushtrim i bekuar që të flon ta dinamizosh duke rendur në hap me të dhe me evoluimin e saj. (Baki Ymeri)

ISBN 978-606-8041-53-7

BUKURI E BEKUAR - Neki Lulaj - DIE GESEGNETE SHÖNHEIT

BIBLIOTKA
Letërsi shqiptare
Këshilltar editorial
Dr. Luan Topçiu
Reçensent: **Skënder Zogaj**
Lektor: **Bexhatr Rexha**
Korektor: **Remzi Limani**
Ballina: **Laura Rushani**
Redaktura artistike: **Amanda Edit**
*****
Ky libër del në dritë në Bukuresht, në bashkëpunim me Bashkësinë Kulturore të Shqiptarëve të Rumanisë

Descrierea CIP a Bibliotecii Naţionale a României
LULAJ, NEKI
Bukuri e bekuar / Neki Lulaj ; pref.: Hasan Qyqalla. –

Sinaia : Amanda Edit, 2012
ISBN 978-606-8041-53-7
I. Qyqalla, Hasan (pref.)821.18-1

Neki Lulaj

(Poezi – Gedichte)
Redaktor: **Baki Ymeri**
***
Parathënia:
Hasan Qyqalla
Amanda Edit / Verlag
Bukuresht (2012) Bucureşti

ZËRI I ZEMRËS DHE SHPIRTI I FJALËS

***Neki Lulaj* i jep prioritet substancës poetike, afshit të dashurisë dhe sentimentit që përfaqëson zërin e zemrës dhe shpirtin e fjalës. Ai e ndjen veten të degdisur në mesnatë, duke parë se si biejnë yje dhe pëshpëritje nga qielli, fjalë të ëmbla dhe loti i heshtjes që të shoqëron. Shpirti i tij noton nëpër yje, duke tentuar ta prekë diellin e hënën dhe qiellin. Dhe, kur dielli lind, shpirti i tij shndërrohet në det dashurie me reze shkëlqimtare dhe afshin e zjarrtë të përmallimit ndaj atdheut dhe bijve të shqipes që derdhën gjak për ta bërë Shqipërinë Shqipëri. Neki Lulaj është poeti i lirisë, skulptor fjalësh dhe mjeshtër i artit poetik, i ngarkuar me meditime filozofike, ëndërrime, fluturime, përjetime të ëmbla e të dhimbshme, dhe, siç thekson Hasan Qyqalla, vargu i tij ka një përmbajtje të lartë artistike dhe një ndjeshmëri të thellë ku reflektohet realiteti i shqiptarizmit në Kosovë dhe Diasporë.** Libër i mirë është ai që na e kultivon shpirtin duke na pajisur me mendime e ndjenja të bukura. Frymëzimi buron nga syri magjik, gjaku i dashurisë dhe zëri i zemrës. Në këtë vëllim defilojnë emocioni, dhembja dhe ballafaqimi me realitetin. Poeti shëmbëllen me ushtarin, me famullitarin apo me flamurtarin e batalionit. Lirika e Neki Lulajt është një forcë e gjallë e vitalitetit shqiptar me tingujt e gjallë të shqiptarizmit në diasporë: "Nëpër furtunën e detit/ Të lundrojmë së bashku/ Të dalim buzë Kepit/ Të Shpresës së Mirë/ Për ta ngritur Kalanë." Ai dëshmon se e ka përvetësuar historinë dhe e ka ndjerë gjuhën shqipe si një xeherore të florinjtë për të krijuar vlera të reja. Poeti është mbret që e kupton letërsinë si një ansambël meditimesh sociale, patriotike dhe filozofike, që ta përkujton Kantin e dikurshëm, i cili e kundronte kulturën si një gjeometri ku zotëronte teoria e tij si një metaforë e kohës, hapsirës dhe mjeteve tjera për rrumbullakësimin e jetës, një kushtrim i bekuar që të fton ta dinamizosh duke rendur në hap me të dhe me evoluimin e saj. **(Baki Ymeri)**

Në vend të parathënies

PËRSIATJE EMOCIONALE POETIKE

Në ligjërimin poetik të Neki Lulajt gjejmë një shtrirje të pakushtëzuar, gjithnjë në kërkim të tematikës harmonizuese e të konsoliduar poetikisht. Pamja e parë na jep një shfaqje deshifrimi shpirtëror dhe emocional, konvertuar me simbolikën e bukurisë, duke u nisur nga mitet e deri tek e sotmja. Poeti pikësëçari i jep prioritet atdheut, gjegjësisht kombëtares. Subjektivizimi ka vlera funksionale që tejkalojnë, ndoshta, edhe konturet e barasvlerës apo nivelizimit real në kohë. Si ilustrim kemi poezinë e parë "Lulet e shpirtit" që tingëllon po kaq bukur: Portretin e Atdheut/ Ta ruajmë në zemër/ Ta stolisim me ngjyra/ Duke shtuar bukurinë/ Me buzëqeshje...

Stilizim, ngjyrim, konfigurim, buzëqeshje, lot, oazë, thesare,...etj., janë elemente që hasim të konsoliduara prajshëm në stilin e ligjërimit. Në prapaskenë të krijuesit sikur na shfaqet një autor tjetër me imazhe riakumuluese shpirtërore e mendore, me ideale të ringjallura, falë kujtesës në retrospektivë kur kujton karvanet e ikjes. Prandaj shprehet në mënyrë sentimentale gjithë dënesje, përsiatje drejt mirësisë e shpresëbesimit se mbi çdo cep Arbërie do të lulëzojnë shekuj drite: "Në shekuj drite/ Me mall e dashuri/ E ushqyem jetën/ E kurrë s'u ndalëm/ Me fijet e jetës/ Duke i përcjellë/ Gjeneratat/ Nëpër stinë."

Poeti betohet dhe mishërohet krenarisht në kopshtin e bukurisë së Adamit e të Evës, për "Formulën e pagëzimit" të Pal Engjëllit, "Mesharin" e Gjon Buzukut, shpatën e Kastriotit, Flamurin e Ismail bej Vlorës, Gjuhën e ëmbël të Fishtës, Besë e Kanun, mirësinë e Nënë Terezës, urtinë Rugoviane, gjakun e varret e të parëve, deri tek trimëritë e sakrificat e luftës së lavdishme të Kosovës me komandantët Ahmet Krasniqi, Sali Çekaj, Tahir Zemaj, Adem Jashari, Zahir Pajaziti, Agim Ramadani etj., pa i harruar edhe të pagjeturit e shumtë, nisë nga Ukshin Hoti e deri tek foshnja e sapo lindur ne arenën e betejave të përgjakshme e të pamëshirëshme, ku autori citon se Nënat, motrat, vëllëzërit e fëmijët presin zgjuar e "portat ende rrijnë hapur, në pritje", "Derën e kullës dardane lënë hapur/ Duke shpresuar/ Se një natë/ Do të kthehet Ylberi."

Konceptualiteti ligjërues mbivlerëson apo hiperbolizon kombëtaren karshi ndjeshmëris emocionale që shfaqet toleruese në krijimatrinë artistike. Nuk ka ekzagjirime të theksuara por mirë të ilustruara me harmoni ngjyrimesh e gjithësesi përfillëse. Autori dallon personazhet në vijueshmërinë bazike bilineare me kontraste të bollshme, bile shpërthyese mes atyre negative e pozitive, duke I dhënë përparësi sublimes kundrejt të shëmtuarës, ideales përballë surreales, etj.: "Mjerë nëna n'jetë që lindi/ Mjerë dielli që i dha dritë,/ Mjerë vendlindja që e rriti,/ Horr a pleshtë i pashpirtë!"

Rrjedhimisht , pikënisje gjejmë përjetimet e vetë autorit në zhvillimet koherente, pa lënë anash edhe ndikimet e frytshme nga Rilindësit në situata të apostrofuara, si mërgimi, malli për kryepersonazhet e jetës: Nënën e Babain, pastaj për Kullën, Atdheun, Diellin, Lirinë, Lulen, dashurinë që krijon një "gjerdan artistik", siç thot edhe vetë poeti: "E nga goja burojnë/ Metaforat e urta/ Urtakët / Terrin e zbusin me fjalë/ Diellin e kanë në buzë/ Vargun e kthejnë/ Në hymn e ninullë."

Autori ilustron bukur edhe kopshtin, pemishten, fushën, malin, lumin... Përndryshe nxjerrë peizazhe idilike për Atdheun, me theks të veçantë për Dukagjinin e Lekës përkatësisht vendlindjen e vet, pa harruar trimërinë, bujarinë, mikpritjen, kullën, oxhakun, pra bujarinë dhe fisnikërinë tradicionale: "Bukë misri/ Në çerep/ Kripë deti/ Djathë delesh/ E kajmak/.../ Kafe të pjekur/ Prej oxhakut/.../ Parodi e rrallë/ Mikpritje shqiptari."

Prandaj rezymojmë lirisht se zt. Neki Lulaj, posedon gjuhë komunikative me figura të kapshme letrare poetike. Në lirikën e tij dominon stili funksional, relativ, mbretëron individualiteti i nxjerrë si ekspoze çasti, drejt synimit të së moderuarës së avansuar, mbase autori, ma merr mendja se është mirë të heqë dorë nga zgjatimet e tepruara, modalitet i panevojshëm... Përndryshe, Neki Lulaj krijon relacione të ngushta me lexuesin pasionant, i cili do të bindet vetëm atëherë kur do ta shfletojë poetikën e tij që të josh që në lekturim të parë. ***(***

Hasan Qyqalla)
Syri magjik

LULET E SHPIRTIT

Portretin e Atdheut

Ta ruajmë në zemër

Ta stolisim me ngjyra

Duke shtuar bukurinë

Me buzëqeshje...

Për thesarët e praruar

Në folenë e tij

Të shkrihemi

Në grykë krateri

Me guxim e trimëri

Ta mbrojmë

Atë bukuri

Të rrallë…

Ta shkrijmë

Me pika loti

Çelikun

E me shkëndijat

E gjakut të bekuar

T'i ujisim

Lulet e shpirtit.

SHEKUJ DRITE

Në shekuj drite

Me mall e dashuri

E ushqyem jetën

E kurrë s'u ndalëm

Me fijet e jetës

Duke i përcjellë

Gjeneratat

Nëpër stinë.

E kurrë s’u ndalëm

Kush e përjetoi

Me gjatë se ne

Gjerdanin e vuajtjeve

Kush endi

Fijet e ngatërruara

Të jetës

Nëpër mote

E shekuj.

E kurrë s’u ndalëm

Vetëm për këtë

Durim të pandalshëm

Në e deshëm jetën

Marrëzisht

U dashuruam në Ty

Duke të përkdhelur

Zemrën e shpirtin

Ta falëm!

KRENARIA

Krenaria nuk djeg

Shpirtin bujar

Mëton stinët

Dimrin e tërbuar

Me furtunë e acar

E kthen në pranverë

Me lule behar.

Me lulet e shpirtit

Jeta bëhet

Herë tunel pa drita

E herë

Kanal i thellë

Herë lendinë me

Lule mijëra ngjyrash

E herë shend e verë

Dhe parajsë.

Shpërthimin

E ndjenjave të shpirtit

Krenaria e mban gjallë

Kurrë s’i kam mallkuar stinët

Se ato me vete bartin

Koloritin e jetës

Melodinë e këngës

Cicërrimën e zogjëve shtegtarë

mallin e (pa)thyer

ngjarje ditari.

Shtjellën e shpirtit

Krenaria mban gjallë

Kullat kanë ruajtur

Besë nam e fjalë

Kalatë e dijes

Bedenat e shekujve

Baladat e thurrura

Vetëtimë për mjeranë

Halë për tiranë.

Lulet e shpirtit

Krenaria i mban gjallë

Stinët dinë ta shërojnë

Shpirtin e djegur

Nëpër kohë të krisura

për mote në breza.

JAM

Jam në vendlindje

Në parajsën e shpirtit

Nën ret' e Dukagjinit

Mbi Yllin e Kurbinit

Krenar

Jam ńmes aromë lulesh

Ku dikur mora hapin

Ńmes dy varreve

Më të dashurve

Që jetim më lanë

I gjorë por krenar.

Eci mbi këtë tokë të bekuar

Dekada jete qeparisa e lule

Që t'i nderoj të dashurit

Zemër e lule së bashku

Bukuri e bekuar.

Vargu ma këput shpirtin

Fjala më ngel në fyt

Puth tokën e fëmijërisë

Brumin e shpirtit o mik

Krenari e dehur

Me ngazëllimin e miqësisë.

Me mall nga mërgimi

Fjalët janë lule shpirti pa aromë

Gotën plot Dhe mora

Ta ruaj me fanatizëm

Në muzeun e Krenarisë.

TRUP I PLAGOSUR

Trupi plot plagë

Trungu gjithë varrë

Shtatdhjetë e shtatë plumba

Në shtat' shtete ndarë

Me barot e shpatë

Fshehtas na helmuan

Trojet na i coptuan

Ujqit e uritur

Turq sllav e barbarë

Toka jonë i mallkoi

Këta mercenarë.

Thelbi i fortë na mbet

Kush s`mundi me e tretë

Fjala rrasë prej ari

Sa planeti më i madh

Trupi kullon gjak

Besa me rreze u përflak

Askush në botë s'pat

Këtë fat

Ne kur u betuam

Nga hiri u zgjuam

Dhe kurrë s’u dorëzuam.

Thelbi i fortë na mbet

Kush śmundi të tretë.

KAH DIELLI

Në mesditën e grisur

Kah dielli notojnë

Shpresat e varura

Mbi gravurën antike

Në fluturim

E përbuzëm kotësinë

Epokës së netëve pa gjumë

Morrnicat e trupit

Qarkullojnë

Si vagonat pa lokomotivë

Mbi hekurudhë.

Nga etja kemi vuajtur

Me shekuj

Besa shpesh motrat

E nuset dhe nënat tona

Për të mos rënë

Në kthetrat e turkut e sllavit

Janë hedhur në greminë

E ne padashas

Jemi mbytur edhe në cekëtinë...

Padrejtësitë na patën kapluar

Edhe mjegullat mbi kalanicë

Ata na ndanë përgjysmë

Bile edhe buzët e thara i njomëm

Kur e puthëm pavdekësinë…

GURGULLIMË LUMI

Gurgullon lumi i harlisur

Kur e shkrin dëbora sevdanë

Vala e ëmbël e puth stomin

I lanë brigjet etjen ua thanë

Mrekulli e pa parë

E dashurisë së parë...

Lumi shuan etjen e verës

Uji bëhet burimi i jetës

Shqiponja në qiellin e lartë

Bën roje nderi mbi atdhetarët

Bukuri mbi krahët e shpresës

Dielli bëhet burim i dritës...

Epshet e zjarrit ia kallën rinisë

Ëndrrat e pa shaluara

Mbi qerren me rrota prej druri

Ngarkohen shpresat e dashurisë

Romantike, platoniane…

Në mes ahishtes së kësaj bukurie

Dallëndyshja ndërton folenë

Qeparisë e lule të bukura

Fjala e bukur zbukuron Atdheun.

Mbi kullat shekullore të gurit

Shpeshherë pa asnjë kokërr misri

Lejleku soditë me dylbi

Folesë së shqipeve i thur lavdi…

KRRUTË PLAKU

Një krrutë e ngulur në mexhde

Në arën e djerrë

Një zë që śprau kurrë

Në memorjen

E njeriut prej dheut...

Një shkop plaku

Me njëqind degëzime

Me dhjetë dekada

Me pesë breza nëpër vite…

Shkop i pa rrëxuar

Orë xhepi plaku

Xhamadan me një anë

Testament që ruan diell e hënë...

Testament ishte fjala

Orë xhepi me qystek

Bakfon, strall, unurë e eshkë

Cigarallëk i qehlibarit

Me smollë në bjeshkë…

Një zë i shtjerrur

Nga muret e kullës

Së braktisur

Bari i rritur

Mbi shkallët e jetës

E zogu mbi oxhak

Këngën kurrë s'e ndalë

Melodinë duke e shqipëruar

Me tingujt e pavdekësisë...

NËNA IME

Nëna ime

Jemi gjallë e të ndarë

Jetojmë larg e me mall

Si dy shpirta të çarë

Se na ndau largësia

Pse pse pse

O moj nëna ime

Je zvogëluar kaq shumë

Nga pleqëria

Jam larg e i tretur

Në kurbet i mbetur

Jam tharë e etur

Për këshillat e mira

Për përkdheljet tua

Po vuaj

Në këtë kohë të krisur

Më ka marrë malli nënë

Dhe kam shumë uri

Për një bukë prej misri

Kur me duart e arta

Na gatuje ti bukën

Që piqej nën saç

E ngjyjshim në lëng

Mallëngjimi

E hajshim me djathë

Kur uleshim rreth sinisë

Me shijen e kënaqësisë

Kam një mall në shpirt

Qe po më rëndon si plumbi

Kur ne veshnim tirqit

Prej leshi e jo prej zhguni

Sa shumë gëzoheshim

Si fëmijë kur ishim të rinj

Që ende ngelëm të vegjël

Kur ty të ka rënduar pleqëria

Shpejtë po ikin vitet

Ikin degdisen e shuhen

Po palohen palë-palë

Si një jargan ëndrrash

Sa shumë më ka marrë malli

Për të të parë moj nënë

Zërin po ta dëgjoi

Shumë rrallë në telefon

E shpirti më këputet

Nga mallëngjimi

MUZG MENDIMESH

Ky muzg si xham i thyer

Emri ynë në çdo rrashtë

Ecëm me hapin e thneglës

Era thau rrobet nëpër tela

E unë mbusha valixhet plotë

I vara fjalët nëpër gozhda

Mendimet m’u pehatën valët

Idetë i murosa si tjegullat

Fjalët ngacmonin njëra-tjetrën

Me e pahir (paqëllim)

I trazonin zogjtë e fjetur

Buzët plot qumësht nëne

Flejnë me gjumin e thellë

Me ëndrrën e barit

Mbi valët e Lumbardhit

Shtatzënë sonte

Nata e qetë bëlbëzon

E oshtima e lumit më zgjon gjumin

Qielli është varë nëpër kleka

E hëna me vello vajzërie

Më shkel syrin mes degëve

Më stilizon jetën

Ekstazë dashurie

YLL I GJITHËSISË

Ti je

Fati im i madh

Je dielli

Që kurrë nuk perëndon

Kurrë nuk harxhon

Shkëlqim' i arit

Si engjëll më shoqëron

Je ylli i gjithësisë

Që fatin qëndis

Ditarin e shkruan në rrasa

Mbi gurë si atëherë Teuta

Testamentin la.

Hijet i hoqën ata gurë

Për ta fshehur

Lashtësinë tonë

E sa hoqën

Shkronjat për t'i lexuar

E sa zjarre u ndezën

Në flakë t'arit

Për t'i praruar

E sot… s'e dimë

Fatin e Diellit

Si e patën shkruar

DORËSHKRIMI

Dorëshkrimet ngelin
Në Bibliotekë
Nëpër fletët e shkarravitura
I mbulon pluhuri i harresës
E miu grimosë në heshtje
Ndërton strofullën e kujtesës
Dorëshkrimet digjen
Nëpër gazeta
Fjala e bukur
Qanë me zë
Bukurinë e fjalës
Fute në libër që
Muzat të këndojnë
Kur fjalët vallëzojnë
Dorëshkrimin e hedhur
Mbi fletore
Ma kishte grabitur
Zogu sqep bardhë
Fjalët lidhi në libër
E me të botoje
Përmbledhjën e parë
Sot në Bibliotekën
E sentimenteve kombëtare
Dorëshkrim' i dikurshëm
U bë „Meshar"
I kënaq lexuesit
E studiuseit
Me historinë
E vargut të parë

FAQET E JETËS

Ika në kohë te vranët

Të lashë

Si re pllumbi

Plotë shi

Vetëtimat bubullimat

Më ndoqën deri në kufi.

Faqet e jetës

Furtunat copëtuan

E cicërimat e zogjëve pas

Na thanë ku po shkoni

Gurët mos i merrni

Kullave mos u veni saç.

Faqet e jetës

Furtuna i preu

Ika i vetëm

Mbi kalin e bardhë

Nga lartë shiqova fushat

Mijëra thika

Mijëra plagë

Atdheu im pat marrë.

Faqet e jetës

Furtunat na i dogjën

Ikëm dikurë

Siç ikin zogjtë shtegtarë

Me trup të plagosur

Zemër helm pa fjalë

E shpirt të latuar

Deri në kockë

U betuam në vatër

Se një ditë

Do kthehemi si fitimtarë.

NGJYRË YLBERI

Kërkova dashurinë

Mbi ngjyrat e ylberit te verës

Nje zë jehoi nga lugu

M’ erdhi në befasi

Kërkoje ore i bekuar fatin

Gjatë gjithë stinëve të jetës

Gjurmo mrekullinë!

Si një mister më gjeti

Në Univers

Në vallen e yjeve

Se lëvizja e kohës nuk ekziston

E dashurin e gjeta

Ate që unë dhe ajo e kërkuam

Shtrati i lumit më të bukur

Sërish na bashkon.

E bukura u duk dikund

Si në përrallat e eklipsës

Rrugët e kërkimit u shkurtuan

Mbi rrasat e gurit gjelbëruan

Lulet e kripës u shumëzuan

Trashëgimin dhuruan.

BUKURI E BEKUAR

Plisi i bardhë
Bukuri e bekuar
Sa gjysëm globi
I vjetër
Dymijë vjeçar
Durimi

Më bën nderë
Plisi i bardhë
Mbi kokë dëshmon
Se jemi bij shqipesh
Të rrahur nga erërat
Pa u dorëzuar kurrë
Plisi i bardhë majë malesh
Në krahëror zemër të zjarrtë
Në shpirt prush e flakë
Llavë e pa tharë
Kala me mure pa myshk
Kurrë mendimi nuk na u ndryshk

NUK DUA

Nuk dua

Të rri larg teje

Të duroj më gjatë

Veset e botës lavire…

E mor qyqarë

Nuk dua të jem

Si hije e netëve pa gjumë

Larg bebzave tuaja të përlotura

Aurorë në qiellin e pa fund.

Këtu dua të jem

Urë që lidh dy brigje

Digë që mbyll shtigje

Ofshamë e dashurisë me kanun

Në vendin tim.

Dua të jem pranë teje

Edhe kur ke gëzim

Edhe kur të rrjedhin lotët si lumë

Tradhtia është lakmi e verbër

Në kotarin e qyqarëve

Pa besë pa ligj pa kanun.

MALL ZEMRE

Të shtrihem
Të rinohem
Të çmallem
Të mrekullohem
Me dritën e Parajsës
Në zemrën e Atdheut
Të lirë
Atje ëmbël
Të shijoj
Në pararojë
Gjumin e natës
Si mburojë
Të përkujtoj
Qumshtin e nanës
Dhe nektarin e dlirë
Në qetësinë
E heshtjes
T'më freskojë
Flladvesa e agimit
Atje t'më prarojë
Rrezja e parë e diellit
Të përkujtoj
"Bagëtinë e Bujqësinë"
E Naimit
Të dëgjoj
Dhembjen e kohës
Së krisur

Me gjëmën
E moteve të mykura
Që lëshon toka mëmë.
Të kujtoj me mall
Mjeshtërit
Që thurrën muranë
Në qiellin e lartë
Dhe kafazin e ëndrrave
Me përrallat e gjysheve
Dhe gjuhën e zjarrtë.
Bisedat e miqëve n'oda guri
Krismë pushke
E këngë dasmash
Mbrëmjeve të vona
Kur iu shtua
Edhe një shtyllë
Aradhave tona.
Do të çmallem
Me valle shqiponjash
Si në ditët e rinisë
Kur dëshirat
Rriteshin si lumi
E barinjtë e kombit
Ishin bërë digë bashkimi
Të mbarë shqiptarisë.

ËNDËRRIME
Cila ëndërr freskon
Dashurinë e fjetur
Cila ndjenjë shuan
Mallin e djegur
Dhe etjen e tretur.
Me cilën nxehtësi vullkanike
Me cilin afsh të levarashtë
Derdhet vërshimi i parë
Kur dy të rinjë puthen
Mbi shtratin e shtruar
Me zjarrin
E shpirtit të trazuar.
Cila krijesë e mbarë
Ec mbi ishullin futurist
Me pishë në dorë
Dhe qan e qesh
Me lotin tim
Të kopjoj
Adamin e Evën
Duke ua grabitur
Mollën e artë
Mbi letrën e mbretit
T'ua nënshkruajë

Pavdekësinë e petritit
Dhe përjetësinë e poetit.

LULET E KURBETIT

ERA
Erërat pehatin
Mendimet e mia
Si pemët
E pjekura të vjeshtës
Të varura mbi trungun
E kohës në kalvarë.
Toka kurrë
Kurrë nuk i tretë
Plisat e bardhë
Eshtrat e bijve t'Arbërit
Mbi lapsin e gjatë
Të vuajtjeve shekullore
Nëpër kalvarë.
Universi numëron
Yjet e qiellit
Aq të panumërt
Sa edhe nënat tona
Që lindin foshnje
Mbi Rrugën e Qumshit.
Notoj mbi univers
Mendimet fluturojnë
Më shoqërojnë
Fatamorganat
E diellin dua ta huazoj
Për Dardaninë e Zanat
E pamundur
Të prek me dorë
Atë vullkan të zjarrtë
Mbi qiellin e kaltërt
Kthej në drekë gëzimi
Për miqtë e shpirtit
Me zemrat shqiptare
Të bijve të Krishtit.
Aurorat ikën
Me kororë magjike
Me dymbëdhjetë
Pelerinat engjëllore
Çapëluan
Mbi hënën time
Të ngarkuar
Mbas shpine
Me dymbëdhjetë

Dosjet
E hirit biblik.

JAM NDRYDHUR

Jam ndrydhur

Si këmbët e futura në çizmet

E ushtarit pa numër

Duke vrapuar pas emrit

Në marshin e pafund.

Kurrë nuk kam ndjerë lodhje

Duke gjurmuar historinë

E padrejtësive shekullore

Dhe baladat e trimave

Në qeli dhe llogore.

Më kanë bekuar engjëjt

Më ka pjekur Dielli

Për qëndrimin stoik

Zjarrin e ndezur të zemrave

Ku u ngrohën bijt' e kombit besnik.

Si shtegtar kalova mes shtigjeve

Me kokën time kalistrok

Gardhiqet e thurrura të tradhtisë

Me ta kurrë s'u kumarova

Kurrë në konakun e nderit s'i prita.

M'I TUBONI ESHTRAT

Mbi krahun e pëllumbit

Plaga kullon gjak

Helm

E pëllumbi nuk gjëmon

Nuk rënkon

Ai prap pëllumb mbetë.

Djegë plaga

Si magmë zhavorri

Heshtja shëron

Me puthjet e erës

Diçka po lindë

Po agon.

M’i tuboni eshtrat

Rrugëve të ngushta

Për t’i zenë të gjitha fjalët shqip

Anijet që lundrojnë këndej

T’i bartin eshtrat

Që me ta

Ta shkruni fjalën shqip:

Liri...

ZANORE KOHE

Zjarri zhvesh drurin

Lakuriq

E prushi all mbi

Tangar

Buzë t’i ndezë

Unë s’jam zanore kohe

Por tym e bajrak.

Hëna sonte tokës

Ja praron kufijtë

Ne të dalurit nga

shkopi i dhunës

Vjelim ëndërrat

Si beqarë...

Mbi fije bari shkëlqim

E myshku në lis

Ka hapur ombrellën

Shiut i bën sehirë,

Bari kërkon ujë

E në vendin tim

Të bekuar

Dashuria ka shtëpinë.

TË PRITA

Të prita në udhëkryqin e legjendave
Jo si Kleopartën mashtruese.
Me fanarin e ndezur të shpresave
Me pallton time të grisur deri mbi llërë
Nga të ftohtit u ngri fjala e pathënë
Ku je Shpirti im!
Vonesa jote më bëri akull
Murlani fryente pa u ndalë.
Kur terri qasej frika shtohej
Si mure kalashë arsyeja e pritjes
E priste Heraklin ta hapë rrugën
E dashurisë…
Eja si drita me rrezet e diellit
Të pranverës ekstazë
Shih si puthen agimet e ndezura
Duke e shkrirë akullin e Grenlandit
Në dasmën e bashkimit të parë.

Mbi Devenë e Oqeanit
Odiseun
E kemi bashkudhëtar
Nëpër furtunën e detit
Të lundrojmë s'bashku
Të dalim buzë Kepit
Të Shpresës së Mirë
Për ta ngritur Kalanë.

LULET E KURBETIT

Kush më zbrazë
Lotin e mbledhur
Kush ripërtërinë
Prushnajën e ndezur
Kush më fikë
flakën në shpirtë
Mos vallë hyjnorët
Që rrezojnë dritë
Vera shkund mallin
Me lotin tim
Po more po
Në atdhe kur kthehem
Nga ky mërgim
Jo śju gjej më jo
Zemra troket kokën
E ndezur me mendime
Po ti ku je moj trime
Kurrë nuk çelin
Lulet e kurbetit
Pa mallëngjime
Rrugët e qeshura
Më dalin përpara
Zogjtë shtegtarë
Me flatra t' bardha
Nuk më pret më Nëna
As prushnaja as Baba!

BUZËQESHJE E NGRIRË

T'u ngri buzeqeshja Imzot

Ditët t'i ngurtësoi epoka

Gjeniu mendjendritur

U shkri si qiriri, flalkadani

Zjarr i qiellit që na shndrit

Si drit‘ e diellit

Fjala e parë dhe e fundit

Ishte barrë e rëndë mbi supe

Kurrë nuk luhatet qëndrimi

Para rebeshit të kohës

Miliona lutje e dëshira

Të këputen zinxhirët e robërisë

Vuajtje nëpër mote

Botës nuk i falen mëkatet

Nga lutjet dhe uratat

Pa u përpjekur njerëzia

Zoti nuk bën mrekullira

Imzot pusho i qetë

Mojsiu i betejave shekullore

Vepra e djersa jote

Mrekulli e kësaj bote

Nga nëntoka e shenjtëruar

Deri në qiellin e praruar

Shpirti yt peng i flakëruar

Krenari e kësaj bote

Misionar i paharruar fjala jote

Themel i sovranitetit tonë

MBI KËTË

Hënë e stolisur nuse e praruar

Ngjyrë ari kulluar - Ilirida

Mijëra ëndërra e vargje

Si xhevahirët mbi bari

Për ty i kanë qëndisur

Shqiponja mbi Dardani

Tjetra mbi Çamëri

Kthetrat mbi Mitrovicë

Ulqin e Plavë dhe Guci

Zemrat nga Janina

Me Tiranën në zemër

E Prishtinën në shokë

Me Njishin* në kokë

Drini pëqafon Bunën

Ibri puthë Erenikun

Lumbardhi ledhaton Shkodrën

E Alpet shqiptare

Me Radikën e Sharrin

Bajgora përshëndet Korabin

Mëngjesi rritë shtatin

Dielli derdh rreze mbi ballë

Një rigë shiu mbi Autostradë

E ringjall Dr. Ibrahim Rugovën

Me një shkop e një letër te bardhë

Blerimit ia shtojnë bukurinë

Vellore e nusërisë Dardane

Tokë e dete dhe male e lumenj

Dhuratë e bekuar e Perëndisë

Për zbukurimin e shqiptarisë

**Njishi-qyteti i sotëm i sërbizuar "Nish"*

HAPI IM
Hapi im rrugëve të botës
Ballkona të panjohur
Në qytetin e huaj
Erozion zemre
Ndrydhje shpirti
Si kokrra ulliri
E kokrra misri
Që vërtiten
Nën rrotë mulliri
Për tu bërë blojë....
Ngjyrë e papikturuar
Piketim/kunjëzim/hapi im
Pikturë e pa ngjyrë, lulet e kurbetit
Me lot në kornizën e qëndisur
Me bujashka shpirti
E plasaritur si buzët e shkrumbuara
E qëndisur me fjalë malli
Për mërgimtarë.
Heshtja ime pikon
Mmbi trupin e shtangur
Të asgjësisë, askund s'e dëgjoj
Zërin e Niçes, ngjyrën e fjalës
Së Serembes. zërin e zemrës
Së trëndafilit:
Mirë se ke adhur
Drumtar i rrugës,
Urdhëro!

SI MOS T'JU URREJ
Si mos t'ju urrej
Ore torrollakë
Kur në portë na trokitët
Na u shtirët si lypsarë
Zhelamanë e varfënjakë
Gjakpirës pa gjak
Që na u bëtë bajraktarë!
E ne ju ndihmuam
Si shiu tokën
Si dielli botën
Si qielli që shëndrit detin
Kurse ju u shtirët si „miq"
Meduzat e ishujve të Mërisë.
Shpejtë e tregut vetvehten

Se në majë të gjuhës
Ju mbajtet helmet
E gjarpërinjve të gjakut
Për ata që ju dhanë bukën
Fjalën besën dhe nderën.
U ndamë
Siç ndahen dy botëra
Një botë engjëjsh
Që dhurojnë
Dhe tjetra e xhindosur
Që gllabëron.
Shporruni ore të marrë
Kurrë nuk jua falim fajet
Gjakpirës gjaksorë mëkatarë
Nuk shuhet urrejtja
Pa u shtjerrë Buna
E Valbona pa u tharë.
As toka as lumi
As fusha as ajri
As kripa as buka
As fjala as besa
As të vdekurit
As të gjallët
Kurrë nuk do ta
Shuajnë urrejtjen
Për gjakpirësit
E gjakut shqiptar.

KONTRAST
Kam kënaqësinë tënde
Ndjej krenari nga ky ajër
Zërin kur ta dëgjoj
Konstatoj
Se kontrasti nuk është plak
E largësia na ndanë
Kam frikë mos gaboj
Moisiu im urtak!
Më tremb
Rruga e gjatë
Mbi llavën e mjegullës
Mbi shtratin e lumit
Mbi amfiteatrin e kohës
Spërkatur me stërkala lotësh
Dhe me mykun e harresës
Jetës nuk i bëre lak.
Ndjehem sërish
Rob i lapsit të shkollarit
Armë drite mbi faqen e bardhë
Ngadhnjimtar para stuhive

Si legjendë e gjallë
Gjallëron e gjeneron
Në situatat koherente
Moisiu im fjalë pakë!
Baltën e bardhë
Mbi zemrat e zeza
Gjeneratorë mëkatesh
Që atentatin e fjalëve
E kanë ajër të ndotur
Që vjell ligësi
Si oxhaku i dëshprimit
Duke shkundur
Nga supet e vetullave
Baltën e mërisë së zezë.
Erdhe nga zemrat
Në lagjën shekullore
Bulevardeve të qiellit
Mënjanë shndrit mirësia
Në anën tjetër
Shtrihet dinakëria
Moisiu i strukur
Në gëzhojën e qëndresës
Heshtjen e engjëllit
E pat flori
Dhe veprën e bëri art.

LIS SHEKULLI

Shekulli e mbëltoi lisin
Duke ikur
Dhe e ujiti
Me lotin e dëshprimeve
Mbi lëmashkun e urrejtjes
Me frymëmarrjen e vuajtjeve.
E lisi i urrejtjes
Homofobike
Mëria
Ndaj të tjerëve
Ka rritur shtatin
E xhelozisë
Deri mbi qiell
E hijen e ka lëshuar
Aq të madhe
Dhe aq të gjerë.
Zogut hyjnor
I duhet
Një shekull drite
Me bekime biblike

Që të kalojë
Në anën tjetër të planetit
Për ta zbutur urrejtjen
E këtyre dekadave
Të strukura në kotarin
E mijëvjeçarit të dashurisë.

TRUP I PLAGOSUR

Trupi plot me plagë

Trungu ynë i ngratë

Shtatdhjetë e shtatë plagë

Në shtat' shtete i ndarë

Me barot e shpatë

Fshehtas na helmuan

Trojet na i coptuan

Ujqit e uritur

Turq e sllav dhe barbarë

Toka jonë i mallkoi

Këta mercenarë.

Thelbi i fortë na mbet

Kush s`mundi me e tretë

Fjala rrasë prej ari

Sa planeti më i madh

Trupi kullon gjak

Besa me rreze u përflak

Askush në botë s'e pat

Këtë fat

Ne kur u betuam

Nga hiri u zgjuam

Dhe kurrë s’u dorëzuam.

Thelbi i fortë na mbet

Kush śmundi me e tretë..

MENDIME
Fjalët më śdridhen në buzë
s’jam më ai që isha dikurë
Kur më sulmonin
Mendimet breshëri
I përbuzur i përndjekur
I nënçmuar
Nuk jam më i përmbysur
Si anije e mbytur n’ujë.
Të pabërën se bëj dot
Fatkeqësitë nuk i dëshiroj
Askujt
Tradhëtinë śi fal askujt
Trëndafilat ujis
Me ujin e bekuar
Vendlindjen e kam lot dashurie
Gjumoj e zgjohem me të
Si nëna me foshnjën në gji
Që ka hyjni...

LIQE I NATYRËS
Liqe i zbukuruar
Qiejt mbi ty bëjnë roje
Engjujt shuajnë etjen
E në fluturim shijojnë embëlsinë
Tokë dhuratë perëndie
Për shijet njerëzore
Pyjet me gjola liqeni e prekën
Pendën tënde
Lakove rimën e vargun
E na le kujtim
Aromën e moteve.
Dielli puth sipërfaqen
Vala formon kurorë
Ballin bregut i lagë
Begatinë mbajë në gji
Lasgushin kërkoj n’vargje
Metaforash
Himne poetike.
Nën pallton e tij
Futem pa drojë
Dëgjoj tik – takun e zemrës

Tik – takun e orës në tavolinë
Në xhepin e palltos së tij
Fshihet Vallja e Yjeve
Që shëndrit Manastirin
Bukureshtin Gracin Pogradecin
Djepin e frymëzimeve burrërore.
Porsi bleta që i gëzohet lules
Lasgushi ecte me dritën e ndezur
Të fjalëve
U kthehej fletëve të frymëzimit
Plotë gjethe
Duke u dhuruar bisqe degëve
Që sapo kanë filluar jetën.
Vala puthte qiellin si n'pasqyrë
E dëshirat i ndeznin
Dritat e shpresës
Dashuria e ngrënte shpirtin peshë
Duke ia dhuruar poetit
Dritën e frymëzimit hyjnor.

ORTEK BORE
Heroinës së dëborës
Moti i trazuar i hyri borxh
Duke i zgjuar
Gjumin e lehtë të foshnjërisë
Orteku i natyrës pa mëshirë
Xhelat i veshur me rroba të zeza
Ia morën të dy prindërit
Me të dashur Amserës.
Ëndrrat e fëmijërisë sime
Të ndrydhura
Nën ortekun e dëborës
Në gjumin e parë
Nëna babai vëllai ikën
Me heshtjen e dhunshme
Pa ia lënë
Lamtumirën foshnjës.

Bardhësinë e mijëra fluturave
E lulet e bardha
Gjithmonë
Në vazo dekori i ekspozoi
E borën e bardhë
Nga dritarja e kopshtit
Vështroi a imagjinoi
Dhe ndarjen nga më të dashurit
Kurrë në këtë moshë
Nuk e paramendoi.
Jam engjëllushë
(flet voglushja)
Që do më mungojë
Nëpër shkallët e jetës
Drita e dashurisë:
Përkdhelja e nënës
Këshilla e babës
Edhe përralla e nënlokes.
Jam heroinë e dëborës
Amsera pesë vjeçare
E ngelur bonjake e kohës
Śdi kush do më blejë
Rrobet e modës
Kush do m'dhurojë
Çantën me librat e shkollës
Kur do ťmë vijë vëllau i motrës
Apo 11 shkurti ishte lufta e borës?

TESTAMENTI
Mbi rërën e Bunës
Të larë qe pesë shekuj
Testamentin e kërkoi.
Terë natën
Eca nëpër pyje pa moshë
Jeta na rrodhi si lëmsh
Nëpër muret e zemrës
Nepër rrudhat e shpirtit
Arkeologjin gjurmoj
Gjumin e bëra
Në gërmadhat e shpirtit
Nën hijen e braktisjes
Testamentin e kërkoj
Dheut i mora erën
Tokës i qepa plagët
Të gjitha nuk munda
Trojet t'i bashkoj
Testamentin ta zbuloj
Uji vesh gurin me lëmashk
Gërsheta flokësh të gjelbërta

Mbulojnë testamentin e kohës
Në ballin e gjithësisë
Dielli rreze eklipse lëshon.

RRAHJE KOHËRASH
Më rrahën
Fortunat e kohërave
Si dëbor' e shkurtit
E egër shtërngat
Në Kosovë e në veri
Fryn murlani me stuhi
Si në kohën e Gjergjit të ri.
Mijëra flutura
Të bardha të mërdhira
Nga ky acar
Ma puthin fytyrën
E mbi vetullat e trasha
E gjejnë ngrohtësinë
E motit të madh
Në janar.
Mbusha
bagazhin e vjetër
Me margaritarë
Nuk vlejnë më
Më përshpëriti Shekulli
Se moti i mirë
Ka për të ardhë.

MOS

Mos ndiq ëndërrat

Se janë heshtja ime

I kam fshehur në shpirt

Herë flasin bashkë

Herë janë grindavece

E prap janë tok

Në shqetësime e gëzime

Përmo(r)t.

FAJI
Faji nuk ka moshë

Shtohet si mjegull pylli
Kur s’e pren askush
Sopata pa bisht
Ngulfatet në dushk
Faji rritet si hija
Në shtigjet e mëngjesit
Mund te ngjitet lartë
Edhe mbi shkallët
E mjegullës
Ecë e ecë e ecë
Me zanoret e jetës

MIKU IM
Miku im
Me zemër shkëmbi
Zinxhir vargënor
Ag lirie
Duartë thatë
E shpirtin plotë
I kap yjet në gjithësi.
Kam fuqinë e Atomit
E në sy Kodin e Davidit
Mendja e tij
Shkëndija t’arta
Gjithë krijuesve
Ua dhuron
Metaforën e gëzimit
Nga largësia e përvuajtur
Ia lexova përgjërimin
Zemra e tij ishte frenuar
Pa u trembur
Nga kërcnimet
E një katili
Kurrë në jetë
Nuk kam besuar
Se njeriu ka
Kaq shumë lot
Se nga loti
Vjen vërshimi
Duke përmbytur fushat
Me bereqet të bekuar

NJË HERË
Hipa lartë
Shkallëve të qiellit
Për të fjetur në gjithësi
Hyra mbrenda
Në bebzë të yllit
kërkoj bujarinë

E nga Ballkoni
I qiellit
E sodis vetminë
Atje lartë
Mbi faqet e murit
Ri krenar
Duke e gdhendur jetën
Si skulptori
Ri i fortë
Se kam shumë miq
Me shpirtin skofiar
Që kanë vlerën e vet
E zemrat margaritarë

ZËRI I KULLËS

Mbi themelet e kullës së rrënuar
Vigjëlojnë kujtime
Nga mllefi i barbarisë shekullore
Nga nëntoka e eshtrave të patretur
Nga thellësia e kronologjisë së heshtur
Toka nxjerrë një zë
Me tingujt e gjyshit dhe stërgjyshit
Kthehu biro në truallin e të parëve
Ropërtrij oxhakun e kullës së vjetër
Se këtu darkuan dikurë
Thoti e Toti n'odën tonë
Këtu vështirë ishte
Por këtu jeta vlonte
E kulla me frengji kah dielli
Tymon drejt qielli
Gjer ne Liri...

GJURMËT

Nga largësia vëzhgoj
Fytyrat e buta
E nga goja burojnë
Metaforat e urta
Urtakët
Terrin e zbusin me fjalë
Diellin e kanë në buzë
Vargun e kthejnë
Në hymn e ninullë

Lozonjarët
Ikin pa lënë gjurmë
Mbi gurë
Myshku i mbulon
Gjurmët e gishtërinjve
Të stërgjyshërve tanë
Që as n'ëndërr
Ende nuk i pamë

GURI I BEKUAR
Mbi gurin e strallit
Gjurmoj arkeologjin e vargut
(ndoshta të pashkruar)
Kur të parët tanë ishin këtu
Si një këngë e murosur
N'yllin mëngjesor
Dora tund Rozafën
E me gjirin e djathtë
Foshnjës i jep sisë...
Buna qetë freskkon
Fushat e blerta
Tuf' e ëndrrave
Mite të pathyera
Gjer në fitore
Digë e patundur
Vazalët shkëlqenin
Me rrobat mëndafshi
Deti as mallin
As dritën
As dashurinë
S'e ndali

HIJA
Hija i dha jetë
U shndërrua në ngjyrë
Mbi xhamin e pathyer
Të kujtimit tonë
Bjeshka mori shpendin
Në gji strehoi këngën
E fluturimin kurrë se ndalën
Rrugëve të pulëbardhave
Edhe shtigjet në qiell
I mbyllën me re të zeza.
Gjarpëri me shtatë krerë
I preu rrugën pagëzuesit
Strehua nën rrasë
I grabitë zogjtë
Ditën e kurorëzimit
Sa gjatë thirrëm ne

Nuk e mbaj mend
Tërë natën u endëm
Me nga një fanarë në dorë
Natën e Shën Bartolomeut
Mëngjesi na gjeti
Me një kitarë në dorë
Kur buzëqeshi dielli
Shekulli thuri Himnin
E zogjtë pa dëshmitar
Vunë kurorë

ORË MURI
Shtëpia bosh
Është shëmti
Parmakët e dritareve
Qajnë pa nda
Ora e murit troket
Mbi blozën e hirësisë
Akrepat e orës
Nxjerrin lot
Pse nuk i
Numërojnë numrat
Por rrinë të shtangura
Duke ngrirë heshtjen
Tik – taku ka marrë
Pushimin vjetor
Ku është dora e plakut
Që me çelësin magjik
Jetës i bën roje
Akrepi këputë lotin
Mbi sekundarë
Djersë si avull lumi
Si shtresë jete
Minuti u bë dekadë
Ora u bë shekull
E shekulli kah po shkon
Duke u degdisur

ATJE...
Atje dikund
Tejmatanë
Qilarëve të shtëpisë
Mbi fushën e mbjellë
Me pambuk
E shoh zemrën
E ndrydhur të dheut
Tok' e ashtit tim ilirian.
Mëngjesi
E lind ditën e re

Qielli zgjerohet
Ikni prej strehëve të gjumit
Prej strofullës së mëkatit
Prej përkuljes së dorëzimit
Të përmbysur
Merre jetën e re
Braktis monotonin
moteve lodhur
jeta është
Një lojë e pafajshme
Pentagram i pakënduar

JETA
Çuditërisht
I madh ishte lëmshi
I ngatërruar mendimi
E fija e gjatë
Porsi jeta e pasosur
Jeta është lum i pashtershëm
Që puth dy brigjet
E shtratit
T'përgjumur
E ujë nuk mbushet
As një gotë raki.
Jeta - lëmsh i rëndë
Ngarkuar mbi supe
Ecë i heshturi Imzot
Shekullin bindi
E mundi
Me durim
E vetë iku në Parajsë
Te Panteonet
E kombit tim

TESTAMENTI
Testamenti i t'parëve
Frymonë gjysmëheshtur
Fjalët u bënë vepër
I morën këmbët
U rritën
E gëzuan tjerët
Në kopshtin e Adamit
Ai iku për mjegull
Për të përkëdhelur dritën
Heshtja zbriti prej diellit
Prej reve të qiellit
E prek palcën
E ashtit të dheut
Me brumin zemër

Vullkani i dheut të lakmuar
Në heshtje iku
Në kopshtin e Adamit
Duke rendur
Pas mollës së Evës

QETËSI
Veniten çastet
Qiri mbi tavolin digjet
Drita zbehet
Cigarja në taketuke
Në heshtje
grimos vetvehten
E shpuza rritë shtatin
Tymi i saj në dhomë
Si gjarpëri bretkosën
Kafshon...
Lapsi im kalëron
Mbi letrën e bardhë
Gjen shpirti
Burojnë heroiglifet
E zemrës
Bërthamë shqetësimesh
E lumturish
Gërshetim jete
Sonte edhe lumi
Ka ndërprerë shungulliimën
E shplakave mbi gurë
Karkalecat e verës
Bëjnë gjumin në mugëtirë
Shpendmira ka rënë
Në dashuri me pahirë
Por ikë me muzgun e natës
Me duçe mbi shpinë
E një ditë do të kthehem
Para lindjes së Diellit

MESHARI

Ia numërova
Vargjet dhe heshtjen
M’u duk se u takova
Me Buzukun
Shkallëve të koridorit romak
Në Bibliotekën e Vatikanit
Fola me plakun e urtë.
I dehur
Me dozë yjesh
U takova edhe me
Mikel Marulin
E gjeta
Formulën e Pagëzimit
Dhe Pal Engjëllin
Që digjej nga përmallimi
Për studiusit e rinj
Në pritje
Për zogjtë e shqipeve
Të praruar
Me pupla zanash.
Më pyetën nga erdhe
M’u lidh gjuha nyje
Thash jam biri i arbërit
Jetoj në Dukagjin
Mysafir i shpirtit
Në Bibliotekën
Shtegëtim
Ku dergjet Meshari
Që s’plaket kurrë -
Burim i pashtershëm
I kombit tim.
Nga stendat e heshtjes
Vitrinë e prarur
Më thërret
Ungjilli i Buzukut
Pa më merr në duar
E më dërgo atje

Ku shekujt e presin
Dritën time në Tiranë
Bijtë e shqipes
T'i shoh të bashkuar
Sa herë më ftojnë
E vijnë të buzëqeshur
Të më vizitojnë...

IDIL MËKATI

Ju mekatarë
Pa më leni
Në hirin e përjetësisë
Në trishtimin tim
Isha Teolog i shpirtit
Me gjak Shqipërie
Më leni të qetë
Në shtratin e lindjes
Eshtrat të prehen
Në tokën e arbërit
Gjumin gjumë dua ta bëj
Mos u tallni o burra
Me eshtrat e mia
Se ju dënon etika
Ju gjykon paria
Ju mallkon historia
Klithi zëri i teologut
Lart nga gjithësia
Kur anadollakët
Ia nxorrën eshtrat nga varri
Gjëmoi qielli nga mëkati
U hodhën buzë Prishtevkës
Qentë lozin me eshtra
Dhe aty u ngrit xhamia
Mallkoi Pjetër Bogdani
Dorën gjakatare
Bekoi truallin e Arbërit
Ku rriti shatin djaloshar
Dhe natyrën e ndritur
Që dhuroi margaritarë
Zotërat e ndalën shiqimin
Mbi hatanë e asaj dite
Kur korbat e krimit
E nxorrën nga varri
Dhe eshtërat e Trimit
Zvarriteshin rrugëve të Prishtinës
Qentë e pamëshirshem
Luanin lojën e tërbimit

SHALLI I ERËS

Kur shkrin
Akulli i shekullit
Heshtja kafshoi dhembjen
Para stolive t'Atdheut
Urat e bekuar
Ngjyrë i dha bukurisë
E jetë fjalës
E pluhurin e moçëm
Ngarkuam
Në qerre kuajsh
E fluturimin
Varrosëm nën qershi
Pakë patëm ngelur
Por jeta
Ishte një sihariq
U ripërtëri
Ai ishte aty
Se kishte arritur i parë
Me qerren e mundimit
Të vuajtjes
Me shallin e erës
Shekullin e pagëzoi ringjallje
Jetë i dëshiroi gurit e drurit
Me pak fjalë
Me shumë dashuri

BORXHI
Nuk frenon mendja
Për asnjë çast
Oshilon kalëron
E trokitjet e zemrës
Pralmisë mbi hartën e vjetër
Të trojeve Ilire
Fluturon me kuajt e erës
Pëllëmbë për pëllëmbë
Me shpejtësinë e dritës
Masë Atdheun
E t'parëve tanë.
Them me vete
Kurrë s`mund të laj
Borxhin Atdheut
Isha dhe
Ngela fajdexhi
I botës
Mbi glob
Mësoni ju pasardhës
Se borxh i kem Atdheut.
Mëkatet nuk pastron
Uj bjeshke

As dritë e tokës
E shpëlan nderi
i atyre që u anatemuan
Për liri
Në secilin shteg
Në secilën hije
Shkruajmë epitafe
Pantheon dashurie.

HESHTJA
Jetën e qëndisëm me heshtje
Ai shkroi monotoninë
E heshtjes kur s'duhej
Fjalën kolosale e ruan
Si plumbin e fundit
Me heshtje e punë
Mundi i t'paheshturit
Veprën e madhëron
Zbriti me heshje në thellësi
Heshtja fluturoi në gjithësi
Apostujt u ngjitën shkallëve
Të jetës në pavdëksi
Në zemër të dheut
Gjurmoi eshtrat e të parëve
Tokë e përvëluar nga vuajtjet
Atje takoi panteonet e kombit
Që i bënin nderë Mëmëdheut
Heshtjen e pat fjalë
E fjalën e pat ar
Në heshtje e pat fshehur
Edhe dritën e diellit
Edhe llavën e zjarrit
Me heshtje triumfoi
Mbi betejat e paparashikuara
E pushtoi heshtjen me punë
E mundi dhunën me heshtje
Perlë e rrallë
Që s'u dorëzua kurrë

PLATFORMA E PADURIMIT
Një pritje me ethe
Kohën e ftohët e mallkova
Në pritje i vetmuar
Çdo kalimtar rasti
Në heshtje
Një nga një i numërova
Dolën shumë
Nga pritja e gjatë
Për Ty

Të gjithëve ua lexova fytyrën
Seicili kishte nga një shkëlqim
Që rrezaton kurreshtje
Kalonin e iknin ngutshëm
Por asnjëri s'e shiqoi në sy
Pritjen time
Lëvizjet ishin
Si një lojë e bukur
Zbukuroheshin si hijet
Si lulet
E unë zhelani i pritjes
Me kollare e kostum
Fytyrën e pritjes
S'ma lexoi kush dot
Koha nuk i la të gjithë
I patën hyrë borxh
Më dukej si një ëndërr
Me tringëllimën
E zanoreve të mia
Dielli shkëlqente mbi çati
Heshtje e zhurmë bashkë
Era lëmonte gjethet
E tallej me flokë kaçurele
Dita e hante vetveten
E unë prisja ate
Që duhej të vijë
Me shpejtësinë e erës
Duke ateruar
Me flatrat e padurimit

MONOLOG
Me gjakun e të persekutuarve
U shkruan emrat që na mungojnë.
Piramidat e eshtrave nëpër arkiva
U futën në arkat e kujtesës
E armiku i groposi thellë ne tokë
T'ua zhdukë gjurmët…
Heshtja bluan urrejtjen si
Misrin në mullirin e erës
E mllefi rritej si murrizi n'bjeshkë
Durimi me dhëmbët shtrënguar
E buzët e përgjakura
Asgjë s'i falë harresës.
Kujtesa kurrë nuk i fshiu
Engjëjt që i zhdukën
Pa gjurmë e pa nishan.
Zemrat pasqyrë e thyer
Si tokë e çarë shtojnë hasmërinë
Deri në kupë qielli
Mbi krahët e hënës…

Vuajtjet thellohen si prrockat malore
E urrejtja rritej si lumenjtë n'pranverë.
Kujtesa ngjitej shkëmbinjëve përpjetë
Ilaçet kurrë nuk shëruan plagët e rreshkura.
Gurët e rëndë mbi ballin e vuajtjeve
Toka thithte frushkuj gjaku
Kufomat e varrosura tinëzisht
I bënë rrafsh me tokë i mbollën
Trungjet e vuajtjeve qau mali
E qielli dhe toka kurrë s'u pajtuan
Me gjakpirës e vrasës
Me kameleonë
Me kanibalë e vazalë.

KËMISHA
Këmishën të prerë pa kopsa
Na veshën me dhunë
E ne s'e deshëm
Se patëm jataganë
Qyrka e kobure
Plisbardhë shokën
Dhe zemrën plot
Duke u zgërdhirë
Bënë dasmë të mallkuarit
U puthën gjithë natën
Me gotat e akloolit
Si lugetër pollën kobin
E albanofobisë.
Tradhtisë
Kurrë nderi nuk i takon
Dora që nënshkruan
Me sharrë në zemër
E në gjirin e vet fut
Gacat e ndezura
Nga krateri i vullkanit Ilirian
Mburojë e historisë
Mësues' e jetës
Testamentin laton.
Nga ashklat e zemrës
Diçka mallkon eshtrat lëvizin
Në tokën e praruar nga thellësia
Diçka kumbon
Mos luani me gjakun
Flaka e mallkimit
Ju përvëlon!

Shtegtim dashurie

GJURMË SHPIRTI

Gjurmët e mia

Të ngelën në faqe

Kujtim i paharruar

Hartë e pikëpjekjes

Së ndjenjës

Në oqeanin e syve tu

Shtatë milionë ngjyra

Rrjedhin lumenjtë

E ëmbël të dashurisë

Gjurmëve të kohës

Vullkan tektonik

Eshtrat s'i tretë dheu

Kujtimin s'e zbeh koha

Zjarri i dashurisë

Nuk shuhet kurrë

Prushnajë vullkani

Besa krijon vepra

Fjalët s'i merr era

Kujtimet e shpirtit

Përkunden në djepin

E atdheut të dashurisë

ZJARR DASHURIE

Sa zjarr dashurie

Ka kjo zemër pellg vetmie

Kush nuk ma shuan mallin

Rrugëtimin drejt vatrës amtare

Sa kujtime zhagitë truri

As treni me vagona nuk i bartë

Sa përjetime bart burri

Anija e Titanikut me vehte s'i bart

Sa ëndërra e mall ka shtegtari

Zogu me flatra të bardha i pat marrë

DIKURË

Mbi kodrën e thatë
Në vendlindje
Diku kish rënë
Ylli polar
Çudi e paparë
... dikurë.
E bukura e fshatit
Ka veshë
Vello nusërie
ngrit
maj kodrës
... u kthye
Me unazë në gisht
Në shoqëri
Me mbretin Longar.
Eh sa dasëm të madhe
Bënë trojet
Zjarri i lashtë rindez
Plisat e bardhë shkëlqenin
Kënga e djemve e vajzave
burrave plot tre javë
Fusha kodra lugje e pyje
Kënduan për nusen e re

Gjithë fisi vlonte nga gëzimi
Jeta ringjall
Zemrat e bekuara nga Zoti
Rikthyen gëzimin mbi Arbëri
E jetën e përtërinë
Dashuria regjenerin...

MAHNITJE
Hej moj
Simfoni e pambaruar
Kitarë e penë në dorë
Shtizë flamuri për krushqi
Në dasmën e madhe "tridhjetë vjeçare"
E sonte duan të çmallen
Me ju
Ju që me ta dikurë
Ndarë keni një kokërr krip
Mbi gazetat e kohës
Tok farkonit
Fatin e Atdheut
N'ilegalitet
Tri roje në pararojë.
Në shtratin e dergjur
Të çmallemi me pavdeksinë
Trinom atdhedashurie
Nder kombi përjetë
Lule t'pavyshkura
trase Pavarësie
Janarëve të përflakur
Të borës së skuqur
Me fanarë lirie.
Korbat grabitqarë
Hutat parazitët lakuriqët
Lugetërit e natës
Përbindëshit
Mbyllën
Portën e konakut
Bënë „nderë"
bënë puç…
E Dasmën kurrë
Śe zhbënë
Mbi idealet e ndritura
Flakë janari
Pavdekshmëri
Zemër Shqipëri
Dritë ardhmëri.
Bacë
Ata treguan satrapsinë e vet
Teli i skuqur i kitarës

U këputë për një çast
Gjëmoi dhimbje vllazërie
E Nënë Ajshja më thirri
Nga Duboviku
Bir ruaju nga armiku
Pikëllimin munde me kranari
Se prej korbave të zi
Nuk pritet mirësi.

MIKPRITJA

Bukë misri
Në çerep
Krip deti
Djath delje
E kajmak
Patate prej
Trapi
Gështenja prej
Kotari
Ftoj prej
Arke
Arra prej
Hambari
Mollëkuqe
N'arkë
Kafe të pjekur
Prej oxhaku
Duhan kaçak prej
Bakfoni
Parodi e rrallë
Mikpritje shqiptari.

UDHËTARËT
Udhëtaret e globit
Janë flera diellore
Janë stuhi
E dielli është plazmë
Ata
Malli kurrë
S'i ngopë
Malli kurrë
S'i ndalë
Malli kurr
S'i lodhë
Llavë eruptive
Kalojnë
Në shtegun e

Qumshtit
Jemi qenie kosmike
Bashkë
I presim zanoret
Në portën e bardhë.

TEK URA
Tek Ura e Moraqës
Me pritë Osa Kuka
Atje ku Vranina
Etjen e shuan
Shkojmë te kulla mitike
Kërkojmë gjurmë
Koha i gllabëron
Njalat e Liqenit
Notojnë të lira
Rozafa roje iu bën roje.
Kurrë mos u mashtro
Kurrë mos u tradhëto
Se kurtha e pabesisë
I ka një mijë të liga
Barotin fshihe në Kullë
Se me verë të kuqe
Darkën në Vir Pazar
Osa Kuka me shqiptarë.
E konakun ilirian
E kemi në Shestan
Atje ku çel lulja në gurë
Zanat shqiptare
Ruajnë zakon e kulturë.

E PASHË
Në grykën e Koronës
Kam parë ylberin
Njëmijë herë
E mbi petalet
E lules
Lirinë në Pranverë.
Kurorën ua dhurova
Zogjëve sqep bardhë
Që me flatra puthnin
Tokën
E me gjuhë
Lëpinin gurët
E vatrës
E zjarrin ndezin
N’oxhak
Me buzë qehlibar.

SHTEGTIMI

Shtegtimi im kosmik

Është prafullimë yjesh

Nëpër shkallët e jetës

Mbi brigjet e përjetësisë

Dhe shkëmbinjtë e bjeshkës

Rrugës plotë me leqe

Gjunjët m'u patën zalisur

Kodrën e zgjova

Nga gjumi i dimrit

Shpatijet i ngarkova

Mbi supe duke gulçuar

U ngjita majë bjeshkësh

Që ta prek qiellin

Në atë lartësi të bekuar

Të takohem me diellin

Ta shoh duke aguar

Shkallët e kohës

Për t'i ndërtuar

Deri lart në yllësi

Nuk do të jem më i kapitur

Yll në gjithësi

Por lumë i kthjelltë

I ftohtë akull i brishtë

Që zhdirgjem

Nga majet e praruara

Për ta shuar etjen tënde

Zile e shpirtit tim Alban

ZJARRI
Kur Nënëlokja
Na vizitoi në Perëndim
Fluturoi nga Parajsa
Në krahun e zogut jetim
Pasë shumë vitesh
Me lot përqafimi
Në dhe të huaj
solli ujin e burimit
ťa e shuaj etjen
E zjarrt t'mallimit
Dy ftonj në çantën e dorës
Me aromë Kosove
T'ka sjellë Nenëlokja
Të qërosh
Njërin kur bie në tokë
Fjollë dëbore
E tjetrin
Kur natyra vishet me gjelbrim
Sa here që thërret vendi im
Ja dhe mollët e avlisë
shijo sa janë t'ëmbla
Për nipërit e Nënëlokës
Qenka më afër
Se Bërliqi nga Prishtina
Pse nuk na vizitoni më shpesh
Pse çdo fundjave
Në katund nuk vinë fëmija
Tha Nënëlokja
Në kurriz mbi 80 vjet
Mysafire ardhë n'kurbet

LUGINA E BEKUAR
Nëpër faqet e kohës
Armiku i xhindosur
Kur dëgjon për Arbër
Gjak e hi dhe varr
Në sy na ka si halë
Mbi bukën e përditshme të dijes
Kore misri me durim e kushtrim
Mbi traditën diell i shëndritur
Mbi krahët e shpresës bashkim

Nje ditë do të rrënohet hipokrizia
Dhe të gjitha kultet e padrejtësisë
Mbi tingujt e këmbanave lajmtare
Do të shëndrrisë rrezja e lirisë
Në faqet e bardha plot shkëndija
Presheva nuse e bashkimit do të agojë
Herët a vonë do të jehojë një jehonë
Mbi liqenin e nën qiellin e bashkimit
Do te nusërohet Arbëria e jonë
Mbi retë e ngritura mbi fier e myshk
Përmbi furtunat dhe djersët e stuhisë
Do të përdhosen muret e ndarjes
Presheva do t'i hapë portat e ardhmërisë
Përmbi pragjet e zemrës
E mbi idealet e pa fjetura
Me afshin e zjarrit të bekuar
Sërish do t'i bashkojmë trojet e vjetra

KUSH
Kush qëndisë sonte
Mbi gjergjefin e ëndrrave
Me gjilpërën e vashave të fejuara
Me këngën e zogjëve të qiellit
Të lastruar
Të çmendur pasë dashurisë
Kanë ngritur çerdhën
Nën dritarën e Hyjneshës së Diellit
Diçka ma tremb natën
Lakuriqët fluturojnë në vëzhgim
Grabitqari i territ
Vazhdon shtigjeve të plaçkës
Rrugës së turpit
Fluturimi i tyre mallkim
Kalorsëit e dasmave të mëdha
Zogjëve u dhanë premtim
Se çerdhet e tyre
Nën dritarën e hyjneshës
I mbrojnë me shigjetat e Trojës
Zogjtë lozonjarë që kendojnë
Këngët më të bukura të botës

FLUTURIM
Nga vendet e largëta
Fluturuan zogjtë
Shtegtarë
E etja i shtrëngoi
Nëpër kohë
U ndalën te breglumi
T'i njomin buzët e shkrumuara

Por zoti u paralajmëroi
Se lumin e kishin helmuar
Zogjtë vazhduan shtegtimin
Fluturuan si engjëjt
Me shpirtërat e fëmijëve
Të padjallëzuar
Mbi flatra
Etjen e bartën me vete
Zoti i erërave ua mësoi rrugën
Pa u lodhur nga rrugëtimi
Cakun e puthën
Pasi papritmas i gjetën
Portat e hapura të shpirtit
Me përgjërim
Zoti i shiut dëgjoi cicërimën
Tuboi retë dhe ua lëshoi shiun
Për ta shuar etjen e imagjinuar
Zotin e shiut e bekuan
Buzët e shkrumuara
I njomën me ujin e bekuar
Freskia e Parajsës
Dhunti e pa imagjionuar

MA FAL
Ma fal
Atë që ta fali Perëndia
Bukurinë…
Se dhuratë e ke
Dikujt për t'ia dhuruar
Ma fal buzëqeshjen
Në janarët e ngrirë
Akullin e zemrës
Ma shkrij
Anijet për të lundruar
Ma fal
Atë që e shkrinë mallin
Si dielli vesën që e terr
Ma fal trëndafillin e zemrës
Qe ta ujis me lotët e besnikërisë
Dhe të dashurisë…
Unë flasë me heshtjen
Ti śfet por ofshan…
Më thuaj a e kërkova
Më shumë se atë
Që Perëndia ty
Dhuratë ta pat dhënë

YLL I TREMBUR
Kur ndrydhë pikëllimi

I yllit të trembur
Mbi qiellin e pa matur
Urrejtja merr zjarr
Hijet nëpër shtigje
I njomë shiu i vakët
Lulet ńmes të therrave
I ngrohë mëngjesi në ag…
Shtrirë një dorë e lypsit
Me zemrën blozë
Varfanjaku i lodhur
Një kothere buke kërkonë
Kush e hodhi në arkivol
Kosovën tonë
Troket derë më derë
Duket si kusarë
Vajmedet si në Mesjetë
Kush ka zemër të dlirë
Diçka për t'i falë.
Shpirtvuajturi tretet
Rrugëve të pa fund
Me gjuhën e shkopit
Këmbanat e mjerimit
Kurrë s'i morën fund…
Të pasurit kalojnë pranë
Shiqojnë me nençmim
Dhe me fodullëk antipoetik
Në luftë i la të shtrenjtit e vet
Kambana e mjerimit
Për kujtim në votër i mbet

GJUMI I IKUR
Tërë natën bëra sehirë
Se gjumin ma vodhi
Ajo që po ngërhatë
Tejamtanë murit tim.
Recepcionieri dremit
Nata është zhytur në thellësi
Si një kënetë e përgjumur
Mbi moçalet e jetës.
E unë mbi tavolinë
Si qiri i ndezur
Në katër kënde
Stuhi e papërgjumur.
Sonte shfletoj kujtimet
Dua ta pikturoj fytyrën tende
Dua ta shkruaj emrin tënd
Me gjakun e zemrës sime…
Kanjusha ime e bardhë
Mos je lejlek zemre

Në gur do ta gdhend fytyrën
Lotin mbi faqe e shijova
Ëmbëlsi e njelmët
Margaritar.
Loti i kripur
M'i shëroi plagët e shpirtit
Mehlem për varrë
Vellon do ta blejmë bashkë
Në Vlorë shtizat flamuri
Për Dasmën së madhe
Që do ta trondisë
Nëntorin e dashurisë…

NË VELANI
Një ditë janari mori pushim jeta
Një bjeshkë sa maja e Gjeravicës
Plaku i fisit tim
Me baballarët e kombit
Rreth mangallës prushnajë
Oxhaku - i bashkoi jeta
Në Parajsë…
Vioritin e puth rezja
Dy kokrra loti për ty
Intelektuali i hjekave
Simboli i fisit tim
Rrallë i lindin kombit
Burrat si ti!

PRA
Sonte natës
Pulëbardhat i bejnë konak
Mbi dallgët e trazuara
Palohen valët e ëmbla
Të detit të njelmët…
Rrëpishëm mbi shkëmbin e gëlqerosur
Thejnë qafën valët shkumë
Në stërkalë…
E pulëbardhat gjuajnë ëndërrat e tyre
Duke çukatur peshkun e artë…
Nata ushton e merr në gji
Ulqinin Plak, e marinari
Me barkën mbi valë
Qëndresës i bën konak…

PORTA
Porta e hapur
Karrocë nusërie
Mbi vetullat shekullit
Flamur Dardanie...

Krushqit e fiseve
Me metafora
Bluajnë fjalën mëvehtësi.
Ata
Që betimin e dhanë
Dhe nxorrën gurë
E vetë hynë si vetëtimë
Në zemër të rrasës së zogut
Hapën dritaret e jetës
E shekullit i dhanë dritë.
E rrasa e Zogut
Përkundët lehtë
E levarshtë, e qetë
Në djepin e lirisë
Me baladën
E prillit të thyer..
Nga Kosharja në Lezhë.

HISTORI
E lidha historinë
Me shallin e mbrojtjes
Që t'ia mbuloj gjurmët
E fytit të përgjakur
E lidha bre
Mbi qafën time të përvuajtur
Fyti im lum i tharë nga britmat
Shtrat i shkretëruar nga etja
I rrahur me shuplaka ere
I goditur pa mëshirë
Nga kërbaçët e tërbuar
Të skllavërisë sllavjane…
Fyti im
Lis me hije të madhe
Strofull për të gjithë zogjtë
Shkëndijë e dritë burimi
Rritë me panteon trimërie
I lyer me ngjyrë gjallërie
Që kurrë ngjyra si bie
Eheee, obububuuuu
Po sa e gjallë është historia
Dhe sa e madhe është shqiptaria...

BIBLIOGRAFI

Neki Lulaj u lind më 13 janar të vitit 1955, në universin e fshatit shqiptar (në Bërliq të Pejës). Është njëri nga poetët më të frymëzuar të diasporës sonë. Shkollimin fillestar e finalizoi me sukses të shkëlqyeshëm, në shkollën fillore katërklasëshe "Liria" në Prapaqan. Gjatë kësaj kohe pati fat ta kishte mësues Ramiz Popovcin, i cili kishte mësuar një vit më parë me martirin e shqiptarizmit, Jusuf Gërvalla. Gjimnazin „Vëllezërit Frashëri" e kreu në Deçan, duke udhëtuar nga 15 km. në ditë në këmbë, së bashku me patriotin e famshëm, Komandantin e Kosharës, Sali Çekaj dhe Qazim Lulajn. Pas përfundimit të gjimnazit u regjistrua në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (Dega e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe), ndërsa në vitin e tretë, pa u shkëputur nga ndjekja e ligjëratave, u regjistrua edhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike „Bajram Curri", në Gjakovë (Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe), të cilën e përfundoi me sukses, falë përkrahjes profesionale të poetit dhe profesorit të ndjerë, Din Mehmeti. Me shkrime ka filluar të merret qysh në moshë të njomë, duke botuar në gazeta, revista dhe media elektronike, poezi dhe shkrime publicistike me karakter patriotik.

Aktualisht jeton dhe vepron në Gjermani, ku punon si mësimdhënës në një shkollë gjermane me fëmijë shqiptarë, dhe është mësimdhënës i rregullt edhe në një shkollë gjermane. Gjatë studimeve universitare ka bashkëpunuar me disa media të shtypura: Bota e re, Pionieri, Zëri i rinisë, Rilindja, kurse më vonë edhe me revistën Albania. Bashkëpunon rregullisht me gazetat kombëtare Bota sot dhe Zemra Shqiptare, me poezi dhe artikuj të ndryshëm kushtuar aktiviteteve të shqiptarëve në diasporë. Është i martuar me Fetaneten (teknike e mjeksisë) dhe baba i katër fëmijëve të florinjtë (Adriatiku, Albiana, Iliriana, Armendi), si dhe gjysh i Leartit të vogël. Neki Lulaj është anëtar i kryesisë së Lidhjes së Shkrimtarëve, Artistëve e Krijuesve Shqiptarë në Gjermani, koautor i antologjisë "Trinomi i lirisë", prezent në revistën "Shqiptari" dhe antologjitë "Kështjella e ëndrrave", "Shpirti dashurisë" "Trinomi I lirisë" etj.

Bibliografi lirike: „Dardania ime" (Albanezul, Bukuresht, 2011), „Në kështjellën e përjetësisë" (Amanda Edit, Bukuresht, 2011), "Zjarri i shpirtit" (Amanda Edit, Bukuresht, 2012), "Bukuri e bekuar" (Amanda Edit, Bukuresht 2012). Për librat e tij janë qëndisur disa recensione të favorshme, në të cilat zotëron realizmi mbi botën sentimentale të një mërgimtari të inspiruar që shkruan me kuptim dhe qartësi për dashurinë dhe atdhedashurinë e zemrave tona.

PËRMBAJTJA – INHALT

PËRSIATJE EMOCIONALE POETIKE / 4
Syri magjik
LULET E SHPIRTIT / 8

SHEKUJ DRITE / 9

KRENARIA / 10

JAM / 12

TRUP I PLAGOSUR / 13

KAH DIELLI / 14

GURGULLIMË LUMI / 15

KRRUTË PLAKU / 16

NËNA IME / 17

MUZG MENDIMESH / 19

YLL I GJITHËSISË / 20

DORËSHKRIMI / 21
FAQET E JETËS / 22

NGJYRË YLBERI / 23

BUKURI E BEKUAR / 24
NUK DUA / 25

MALL ZEMRE / 26

ËNDËRRIME / 28
Lulet e kurbetit
ERA / 29
JAM NDRYDHUR / 31

M'I TUBONI ESHTRAT / 32

ZANORE KOHE / 33

TË PRITA / 34
LULET E KURBETIT / 35
BUZËQESHJE E NGRIRË / 36

MBI KËTË / 37

HAPI IM / 38
SI MOS T'JU URREJ / 39
KONTRAST / 41

LIS SHEKULLI / 43

TRUP I PLAGOSUR / 44

MENDIME / 45
LIQE I NATYRËS / 46
ORTEK BORE / 48
TESTAMENTI / 50
RRAHJE KOHËRASH / 51

MOS / 52 / FAJI / 52

MIKU IM / 53
NJË HERË / 54
ZËRI I KULLËS / 55
GJURMËT / 56
GURI I BEKUAR / 57
HIJA / 58
ORË MURI / 59
ATJE / 60 / JETA / 61
TESTAMENTI / 62
QETËSI / 63
MESHARI / 64
IDIL MËKATI / 66
SHALLI I ERËS / 68
BORXHI / 67
HESHTJA / 68
PLATFORMA E PADURIMIT / 71
MONOLOG / 73
KËMISHA / 74

Shtegtim dashurie

GJURMË SHPIRTI / 75

ZJARR DASHURIE / 76

DIKURË / 7 7
MAHNITJE / 79

MIKPRITJA / 81

UDHËTARËT / 82

TEK URA / 83

E PASHË / 84

SHTEGTIMI / 85

ZJARRI / 86
LUGINA E BEKUAR / 87
KUSH / 88
FLUTURIM / 89

MA FAL / 90
YLLI I TREMBUR / 91
GJUMI I IKUR / 92
NË VELANI / 93
PRA / 93
PORTA / 94
HISTORI / 95
BIBLIOGRAFI / 96